



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

UE QENDRA E KUVENDIT

UE LAJME

dhjetor 2017

UEQ-numër 29/2017



ANULIMI I ROAMINGUT NDËRMJET UNIONIT EVROPIAN DHE BALLKANIT PERËNDIMOR



Komisarja Eurpiane për politikë digjitale, Marija Gabriel në panairin në Bullgari do të shpall plan për anulimin e roamingut ndërmjet UE-së dhe vendeve nga Ballkani Perëndimor.

Bullgaria, e cila e ndërmerr kryesimin gjashtë mujor rrotues me UE-në në 1 janar, do të jetë nikoqire e Samitit UE-Ballkani Perëndimor në Sofje më 17 maj 2018.

Në Unionin Evropian roamingu nuk paguhet nga 15 janar 2017, ndërsa qytetarët të Unionit mund të paraqiten, të dërgojnë porosi dhe të "surfojnë" në internet në pajisjet e tyre celulare sipas çmimi të njëjtë si edhe në shpi.

Megjithatë, komisarja theksoi se nuk mund të parashikojë kur do të hyjë në fuqi marrëveshja për anulim të roamingut ndërmjet UE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Komisarja evropiane për ekonomi digjitale dhe shoqëri për EURAVTIV deklaroi se "shumë shpejtë" do të shpall "më së paku dy pilot-projekte shumë konkrete" në sferën e politikës digjitale në Ballkanin Perëndimor, por nuk saktësonte cilat projekte ose vende për të cilën bëhet fjalë.

Bisedimet për anulimin e roamingut në UE zgjasnin një dekadë për shkak të mospërputhjeve ndërmjet kompanive të tele-komunikimit, të cilat frikoheshin nga biznesi i tyre.

Marija Gabriel, deputete e mëparshme evropiane e cila u bë komisarë për politikë digjitale në korrik, theksoi se për herë të parë në korrik vazhdoi vazhdimi i ndalesës për roaming në Ballkanin Perëndimor.

"Bullgaria "promovimin e politikës digjitale të UE-së të Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet zvogëlimit gradual të kompensimeve për roaming dhe zgjerim të qasjes të përfshirjes së gjerë" e vuri si një nga prioritetet të kryesimit të ardhshëm me UE-në.

Ndërmjet prioritetet të kryesimit në sferën e politikës digjitale do të jetë edukimi i njerëzve të rinj dhe të sigurohet vendet-anëtare të vendosin për draft-ligjet të UE-së për telekomunikime, sajber siguri dhe të drejta të autori.

Zëdhënësi i Ministrisë bullgare për Punët të Jashtme deklaroi se plani për anulim të roamingut ndërmjet UE-së dhe Ballkanit Perëndimor "do ta përmirësojë bashkëpunimin e Ballkanit, me çka regjioni do të mbetet më stabil dhe më konkurrent". Marrëveshje të ngjashme në regjion janë "hapi i parë" për zgjerim të marrëveshjes me UE-në, shtoi zëdhënësi.

Bullgari dhe Maqedonia në nëntor vendosën t'i zvogëlojnë çmimet të roamingut për konsumatorët të cilit udhëtojnë ndërmjet të dyja vendeve. Sipas Ministrisë bullgare të Punëve të Jashtme, ky zvogëlim i çmimeve do të hyjë në fuqi në mars të vitit 2018.

Bullgaria do të nënshkruaj marrëveshje edhe me Serbinë për zvogëlim të taksave për roaming dhe bisedime, ndërsa marrëveshje të ngjashme edhe me malin e Zi dhe Shqipërinë, shpalli zëdhënësi i ministrisë bullgare.

Në vitin 2016, Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia u pajtuan të kërkojnë nga telekom kompanitë t'i zvogëlojnë çmimet të roamingut për klientët të cilit udhëtojnë ndërmjet këtyre katër vende.

<https://europeanwesternbalkans.com>

Përmbajtja e lajmeve:

ANULIMI I ROAMINGUT NDËRMJET UNIONIT EVROPIAN	1
AKTIVITETE TË KUVENDIT TË LIDHURA ME ÇËSHTJET EVROPIANE	2-3
NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN	4-5
POST-2020 STRATEGJI INKLUZIVE DHE KOHERENTE AFATGJATE PËR EVROPËN	6
UNIONI EVROPIAN NGRITI PROCEDURË KUNDËR POLONISË	7
ZGJEDHJE REGIONALE NË KATALONI	8
PERIUDHË E PROPOZUAR PËR ZVOGËLIM TË EMETIMEVE TË CO ₂	9
TAKIM I KËSHILLIT EVROPIAN	10
OPOZITA NË VENEZUELË FITUESE E SHPËRBLIMIT	11

AKTIVITETE TË KUVENDIT TË LIDHURA ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Në margjinat të Forumit parlamentar të sigurisë i cili u mbajt më 7 dhjetor 2017 në Uashington, kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë u takua me koordinatoren e grupit parlamentar të partisë qeveritare GERB në Kuvendin popullor të Republikës së Bullgarisë, z. Cvetan Cvetanov.

Ato biseduan për tema me interes të ndërsjellë edhe atë se Republika e Bullgarisë si kryesuese e ardhshme me UE-në, e dinë rëndësinë e perspektivës Evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor edhe prandaj do të jetë përkrahëse e fortë në atë drejtim. Temë tjetër e rëndësishme për të cilën biseduan janë projektet infrastrukturore regjionale.



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, z. Talat Xhaferi, më 14 dhjetor 2017 realizojë takim me kryetaren e Republikës së Bullgarisë, z-nj. Ilijana Jotova, e cila qëndronte në vizitë të shkurtë pune në Republikën e Maqedonisë. Duke i dëshiruar mirëseardhje të mirë kryetari Xhaferi u falënderua në përkrahjen të cilën Republika e Bullgarisë ia jep Republikës së Maqedonisë dhe aspiratat e saja për anëtarësim në NATO dhe në Unionin Evropian. Republika e Maqedonisë dhe institucionet e veta me përkushtim punojnë në miratimin e pakos të ligjeve reformuese në muajt në vijim, si dhe në përmirësimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, me shpresë për marrje të raporti pozitiv nga Komisioni Evropian vitin e ardhshëm. Në atë kontekst, kryetari Xhaferi kërkoi përkrahje nga Republika e Bullgarisë gjatë kohës së kryesimit të saj me Këshillin e Unionit Evropian për marrje të datës për bisedime për anëtarësim në UE.

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, z. Talat Xhaferi, më 15 dhjetor 2017 u takua me z. Vanino Kiti, kryetar i Komisionit për politika evropiane në Senatin e Republikës së Italisë.

Duke i vlerësuar marrëdhëniet ndërmjet të dyja shtetëve si miqësore dhe pa çështje të hapura, kryetari Xhaferi shprehu shpresë se në të ardhmen e shpejtë do të intensifikohet komunikimi i drejtpërdrejtë ndërmjet shtëpive ligjvënëse të të dyja shteteve edhe atë si në nivel të komisioneve, por edhe në nivel të kryetarëve të parlamenteve.



Më 18 dhjetor 2017 kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, z. Talat Xhaferi, realizojë takim me ministrin për punë të jashtme dhe tregti të Unionit, z. Peter Sijarto.



Gjatë bisedimeve, kryetari i Kuvendit theksoi se anëtarët të Republikës së Maqedonisë në NATO dhe UE mbeten prioritet kryesor shtetëror, politik dhe strategjik në çka z. Sijarto u përgjigj se Hungaria do të jetë zë më i fortë dhe përkrahës i integritetit të Maqedonisë në këto struktura, sepse konsideron se janë plotësuar të gjitha kriteret e nevojshme për anëtarësim të plotë.

AKTIVITETE TË KUVENDIT TË LIDHURA ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Kryetari i Komisionit për Çështje Evropiane i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, z. Artan Grubi, e fillojë vizitën dyditore në Bruksel (6 dhe 7 dhjetor 2017) me pjesëmarrje të takimin "Miq të Evropës", ku realizoi takim me z. Knut Kirsten, përgjegjës për seksionin politik të NATO-së për Maqedonisë, si dhe me përfaqësuesit politik në NATO dhe SHBA, Britania e Madhe, Hungari, Rumani, Slloveni.

Në takimin me eurodeputetin gjerman, z. Knut Flekenshtajn bëhet fjalë për situatë në Maqedoni dhe perspektiva evropiane e vendit dhe regjion. Deputeti Grubi e njoftoi deputetin Flekenshtajn me realizimin e detyrimit të vendit, siç janë ligji për dëshmitar të mbrojtur, verifikimi i fakteve, këshilli gjyqësor dhe përzgjedhja e Prokurori publik.

Vizita në Bruksel, z. Grubi e vazhdoi me realizimin e takimi me z. David Kulen nga Komisioni Evropian, përgjegjës për përpilimin e raportit për Maqedoninë dhe Kosovën. Në takim, bashkëbiseduesit diskutonin për ngjarje në Maqedoni dhe agjenda e reformave e vendit tonë. Zotëri Grubi e theksoi përkushtimin ndaj reformave, sundimit të drejtësisë dhe politikës të fqinjësisë të mirë të cilat janë parakusht për marrje të rekomandimeve pozitive nga Brukseli, ndërsa mandej edhe datë për fillim të bisedimeve për anëtarësim.



Në takimin me z. Edvard Auer, drejtor për Ballkanin Perëndimor në zyrën e z-nj. Mogerini, në Shërbimin Evropian për veprim të jashtëm Grubi dhe Auer i këmbyen shikimet për gjendjen aktuale në Maqedoni dhe regjion, me aksent të veçantë të reformave dhe fqinjësinë e mirë. Pritjet tona janë se edhe Brukseli do të veprojë me guxim dhe me vizion për Evropë kontinentale të plotë dhe të bashkuar - theksoi Grubi në fund të takimit.



Më 7 dhjetor 2017 z. Artan Grubi realizojë takim me eurodeputetin z. Edvard Kukan në të cilin u bë fjalë për ngjarjet aktuale në vend, koalicioni qeveritar, reformat dhe procesi i integritimit. "Që të lehtësohet procesi integruar, ne si shumicë parlamentare, plotësisht jemi të përkushtuar në atë që t'i realizojmë të gjitha pritjet nga Brukseli dhe presim përkushtim të njëjtë nga miqtë tanë në Bruksel", deklaroi Grubi. Zotëri Kukan premtoi përkrahje për në përparimin e proceseve integruar në Unionin Evropian dhe marrje të datës për fillim të bisedimeve.



Vizitën e tij dyditore në Bruksel. z. Artan Grubi e rumbullakoi me realizimin e takimi me eurodeputetin z. Ivo Vajll, referues për Maqedoninë në Parlamentin Evropian. Në takimet z. Grubi kërkoi të valorizohen përpjekjet të Republikës së Maqedonisë për realizim të reformave të kërkuara me marrje të date për bisedime për praninë në Unionin Evropian.



Kryetari i Këshillit kombëtar për eurointegrime në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, z. Nikolla Poposki, më 18 dhjetor realizojë takim me ministrin për punë të jashtme të Hungarisë, z. Peter Sijato, në korniza të vizitës të re oficiale të Maqedonisë.

!Kur do të hyjmë në UE varet nga anëtarët të UE-së, por kur do të evropianizohemi varet vetëm nga vet ne. Prandaj, kujdesi dihet të jetë në përforcimin e institucioneve dhe zbatimi i ligjeve më shumë sesa cila do tjetër", theksoi Poposki.

Të dy biseduesit konstatuan se vendi i Maqedonisë është në familjen evropiane, për çka disa herë deri tash e ka dëshmuar rolin e vet si anëtare e merituar e Unionit.



NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN

**Sesion i planifikuar 11-14 dhjetor 2017**

Rajner Volland, eurodeputet nga radhët të Partisë Popullore Evropiane (EPP, DE) e hapi sesionin fundit të Parlamentit Evropian për vitin 2017 në Strasburg.

<http://www.europarl.europa.eu>

Në sesionin plenar ishin lejuar rregulla të reja për thjeshtëzim të politikës bujqësore të UE-së në drejtim të përforcimit të forcës së bisedimeve të fermerëve përkundër supermarketeve dhe përgatitje më të madhe për ballafaqim me rreziqe.

Reforma e Politikës të përbashkët të bujqësisë (PPB), e cila duhet të hyjë në fuqi vitin e ardhshëm, ishte miratuar me 503 vota për, 87 kundër dhe 13 të përmbajtur.

Rregullat e reja do t'u mundësojnë të gjitha organizatave të pranura të fermerëve ta planifikojnë prodhimtarinë dhe të bisedojnë për marrëveshjet për furnizime në emër të anëtarëve të veta, pa t'i shkelin rregullat për konkurrencë të UE-së. Bisedimet kolektive deri tash janë të lejuara vetëm në disa sektorë siç janë qumështi, vaji i ullirit, mishi i lopëve ose drithërat.

Më shumë detaje për përmbajtjen e reformës janë të kapshme [këtu](#).

Eurodeputetët e vazhduan dhe zgjeruan Fondin Evropian për investime strategjike (EFSI) për 500 miliardë euro deri në vitin 2020.

Pika kyçe të draft-ligjit, të lejuara nga ana e Parlamentit në tërësi janë:

- EFSI, e njohur si "Juncker Plan", vazhdohet deri në vitin 2020 dhe ka për qëllim të mobilizojë deri më 500 miliardë euro,
- do të drejtohet në moseset të tregut dhe zbrazëtitat investuese dhe do të financojë projekte me rrezik të madh të cilat ndryshe nuk do të ishin të përkrahura,
- investimet duhet të jenë të drejtuara në krijimin e vendeve të reja të punës, veçanërisht për njerëzit të rinj, rritje të konkurrencës, energji, mjedis jetësor dhe aksion klimatik, shëndetësi, hulumtim dhe inovacione, transport të qëndrueshëm, sektor digjital dhe industri kreative, dhe
- Parlamenti Evropian merr të drejtë të nominoj anëtarë në Bordin Drejtues të EFSI, i cili mund të sigurojë ekspertizë

plotësuese, me çka do të zmadhohet transparenca dhe njoftimi.

Për nxitje të projekteve regjionale, lokale dhe projekteve më të vogla:

- rregullat të reja parashikojnë rol më të madh të Qendrës evropiane këshillëdhënëse të investimeve me prani më të madhe lokale,

- Banka Evropiane Investuese (BEI), nëse është e mundshme, duhet ta delegojë përzgjedhjen dhe monitorimin e projekteve të vogla të bankave kombëtare të promovimit, mirë të shpërndara të ndihmojnë në mbulimin e regjioneve, projekte të sektorëve ose projekte tejkufitare, dhe

- në rast të theksohet se kushtet në treg do të mund ta pengojnë projektin, BEI duhet jashtëzakonisht t'i zvogëlojë shpenzimet për shfrytëzuesin e financimit.

Rezultatet të EFSI për vendet-anëtare të UE-së mund t'i kontrolloni në ueb-faqen e Komisionit Evropian.

Parlamenti Evropian është i përgatitur të fillojë bisedime me qeveritë të UE-së për rregullat të reja për onlajn televizion dhe radio dhe e lejoj mandatin për bisedime të cilin e përgatiti Komiteti për çështje juridike në nëntor këtë vit me 344 vota për, 265 kundër dhe 36 të përmbajtur.

Rregullat të reja kanë për qëllim të përgjigjen në kërkesën zmadhuar të onlajn TV dhe radio, me atë që u lehtësojnë radiodifuzerëve t'i bëjnë lajmet e tyre dhe programet për ngjarjet rrjedhëse të kapshme edhe në internet dhe vende tjera të UE-së, me thjeshtëzim të procesit të rregullimit të të drejtave të autorit.

Për momentin, radiodifuzerët doemos duhet t'i harmonizojnë të drejtat e autorit për periudhë kohore shumë të shkurtë për çdo vend në të cilën i bëjnë programet për lajme dhe ngjarje aktuale të kapshme onlajn. Me rregullat e reja, ato vetëm do të dihet t'i harmonizojnë të drejtat në vendin e vet.

NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN

Autorizimi për të drejta të autori gjithashtu do të jetë më e thjeshtë për operatorët të cilit ofrojnë pako për parapagesa.

Megjithatë, eurodeputetët theksojnë se është me rëndësi të veçantë të mundësohet geoblokim nëse pronari i të drejtave dhe radiodifuzeri pajtohen ta përfshijnë në marrëveshjet të tyre.

Parlamenti Evropian konsideron se Bullgaria dhe Rumania janë të përgatitura të përfshihen në shenjen zonën; prandaj, kontrollet sistemore të kufijve me vendet fqinje të UE-së duhet të shmangen, sipas rezolutës të votuar më 8 qershor 2011.

Vendimi përfundimtar politik për atë nëse Bullgaria, Rumania dhe Kroacia (pasi që i kanë plotësuar të gjitha kriteret) mund të mbeten pjesë e Shengen-zonës, duhet të miratohet me votim unanim në Këshillin nga ana e qeverive të UE-së.

Në rezolutën të miratuar Parlamenti Evropian e përshëndeti raportin e përbashkët për përparimin e Bregzit-it, i cili ishte i saktësuar nga biseduesit të UE-së dhe Britanisë së Madhe në 8 dhjetor. Rezoluta ishte e miratuar me 556 vota për, 62 kundër dhe 68 të përmbajtur.

Parlamenti deri tash miratoi dy rezoluta për bisedimet, m[5 prill dhe 3 tetor 2017, të përpiluara nga ana e Grupit koordinativ parlamentar Bregzit, me të cilën kryesor Gaj Verhofshtat (ALLDE, BE). Parlamenti në tërësi do të ketë fjalë të fundit për rezultatin nga bisedimet kur do të votojë për lejimin ose refuzimin e marrëveshjes për tërheqje, i cili do të jetë i finalizuar deri në fund të marsit të vitit 2019.

Përfaqësuesit të opozitës demokratike të Venedikut e pranuan shpërblimin Saharov për liri të mendimit në ndarjen solemnet më 13 dhjetor në Strasburg.

Politika e jashtme dhe e mbrojtjes e UE-së duhet të vazhdojë me lidhje më të afërta mbrojtëse dhe përgjigje të fortë të kërcënimeve ndërkombëtare, theksuan europarlamentarët.

Eurodeputetët e përshëndetin faktin që integrimi në mbrojtjen e UE-së është në fazë të fillimi me formimin e Fondit Evropian për Mbrojtje, shtab operativ i UE-së, bashkëpunim i përhershëm i strukturuar dhe pasqyrë vjetore e planeve mbrojtëse të vendeve-anëtare.

Ato dëshirojnë Komisioni Evropian të formojë Drejtorat të përgjithshëm për mbrojtje (DG Defence), e cila do t'i koordinojë iniciativat mbrojtëse dhe do ta lehtësojë lëvizjen e lirë të ushtarëve dhe pajisjes në UE.

Deputetët, gjithashtu, i ftuan vendet-anëtare të ndajnë 2% nga BPV-ja e tyre për mbrojtje për një dekadë, të formojnë fond fillestar për shpërndarje të shpejtë të operacioneve dhe të propozojnë formim të buxheti për mbrojtje të UE-së në korniza të buxhetit të ardhshëm afatgjatë të UE-së.

Në rezolutën e ardhshme të miratuar nga ana e PE-së, në të ciklën shqyrtohen zgjedhjet kyçe për politikë të jashtme të UE-së, eurodeputetët i theksojnë sfidat kryesore të cilat e kërcënojnë sigurinë e UE-së: Proliferimi i armës për shkatërrim masiv, terrorizëm, konflikte të fqinjët në lindore dhe jugore, proksi lufta dhe luftë hibride dhe informative.

Vendet-anëtare të UE-së doemos duhet të bashkëpunojnë ndërmjet veti, në koordinim me Evropol dhe me IT industrinë për luftë kundër keqpërdorimit seksual dhe eksploatimit të fëmijëve, theksuan eurodeputetët. Ato miratuan rezolutë të paobligueshme me të cilën vlerësohet zbatimi i direktivës të Ue-së për luftë kundër keqpërdorimit seksual të fëmijëve nga viti 2011. Teksti, i përpiluar nga Ana Marija Koriza Bildl (EPP, ES) ishte i miratuar me 597 vota për, 6 kundër dhe 20 të përmbajtur.



<http://www.europarl.europa.eu>

POST-2020 STRATEGJI INKLUZIVE DHE KOHERENTE AFATGJATE PËR EVROPËN



Konferenca e cila u mbajt më 27 dhe 28 dhjetor 2017 në Budapest, ishte e organizuar nga Komiteti evropian ekonomik dhe social (KEES), me përkrahje të Shoqatës hungareze ekonomike dhe Ministrisë hungareze për resurse njerëzore.

Ngjarja i bashkoi në një vend anëtarët të KESS dhe ekonomitë kombëtare dhe këshilla social, institucionet të Unionit Evropian, përfaqësuesit të Qeverisë hungareze dhe përfaqësuesit të shoqërisë qytetare hungareze.

Në hapjen e konferencës kryetar i Komitetit drejtues të KESS për Evropë 2020, Etele Barat e theksoi rëndësinë e vazhdimësisë dhe ende qëllimet relevante të strategjisë 2020 të UE-së në përzgjedhjen e skenarit më të mirë për vitin 2030. Qëllimi doemos duhet të jetë përmirësimi i menaxhimit dhe përforsimi i mëtejme i qëllimeve për Evropë të mençur, inkluzive dhe të qëndrueshme.

Filip Lambertus, eurodeputet dhe Peter Balaz, profesor i Universitetit Qendror Evropian dhe komisar i mëparshëm evropian për politikë regjionale, e theksuan nevojën nga investimi në projekte afatgjate, të shmangjet ndikimi nga më shumë interesa afatshkurta ekonomike dhe politike, si dhe të definohet pozita e UE-së në botë dhe çfarë të ardhme dëshirojmë. Gjula Pleshinger, kryetare e Shoqatës ekonomike hungareze, theksoi se pesë skenarët të Junker-it janë pikë e mirë fillestare për aktivizim të debatit. Gabor Zupko, përfaqësues i KE-së në Hungari, shtori se ndërtimi i unioni të tregut të kapitalit paraqet sfidë, e cila vijon pas sfidës me Bregzitin.

Enriko Xhovanini, (aleanca italiane për zhvillim të qëndrueshëm) theksoi se është e rëndësishme të theksohet

barazia adekuate në lidhje me ndarjen e punës ndërmjet institucioneve të UE-së dhe vendet-anëtare, me qëllim të krijohet fleksibilitete i nevojshëm për reagim dhe adaptim ndaj shokut të ardhshëm.

Disa bisedues e prekën çështjen për financim. Korniza e ardhshme shumë vjeçare financiare duhet të jetë e drejtuar ndaj strategjisë së re, duhet të zmadhohet buxheti për resurse personale të UE-së, duhet të vendoset organizatë përgjegjëse për qëndrueshmëri dhe duhet të financohet shoqëria qytetare.

Strategjia Evropiane 2020 së shpejti përfundon, në kohën kur Evropa ballafaqohet me sfida të mëdha.

Shoqëria qytetare duhet të japë kontribut në formimin e strategjisë post-2020 të re afatgjate, si dhe në menaxhimin e saj dhe implementimin.

Prioritet kyç për strategjinë e ardhshme duhet të jetë përgjigje më efikase e pabarazisë së zmadhuar, të krijojë besim në Evropë dhe të sigurojë fer tranzicion për të gjithë.

<http://www.eesc.europa.eu/>

UNIONI EVROPIAN NGRITI PROCEDURË KUNDËR POLONISË

Kryetari i Komisionit Evropian, Frans Timmermans më 20 dhjetor 2017 deklaroi se është ngritur procedurë ndëshkuese sipas nenit 7 të Marrëveshjes për UE kundër Polonisë. Por, megjithatë është dhënë afat prej tre muaj Polonia të bëjë ndryshime të ligjeve kontestuese në jurisprudencë.

Partia Polake Drejtësi dhe drejtësi në dy vitet e kaluara miratoi 13 ligje reformues me të cilat pushteti ekzekutiv prek në institucionet të pavarura dhe gjyqësi. Dënimi për Poloninë mund të jetë humbje e të drejtës të votës në UE ose ngrirje të miliarda eurove nga fondet evropiane.

Sipas Timmermans, Komisioni Evropian e shpalli rekomandimin katërt për Poloninë si për harmonizim të reformës kontroverze të gjyqësisë, para së gjithash Ligji për Gjykatën supreme dhe Këshilli shtetëror gjyqësor me standardet evropiane të shteti demokratik legjitim. Gjithashtu, për shkak të tashmë Ligjit të miratuar për gjykatat e përgjithshme, vendosi Poloninë të padisë para Gjykatës të UE-së.

Procedura ndëshkuese nga neni 7 do të thotë se, në kërkesë të Komisionit Evropian vendet-anëtare të UE-së do të prononcohen nëse në Poloni ekziston rrezik pas shtetit juridik, ndërsa pasi që për atë do të prononcohen 22 anëtarët mund të mendohet për sanksione, nga ngrirja e fondeve evropiane për Poloninë deri më e rënda - marrje të të drejtës të votës për çka nevojitet pajtim nga të gjitha vendet-anëtare përveç nga vendi për të cilin votohet.

Hungaria dhe kryeministri i vet Viktor Orban vazhdimisht paralajmërojnë se Budapesti oficial do të vë veto në çdo përpjekje për sanksionim të Polonisë.

"Pika e fundit e cila e derdhi gotën" e UE-së në dialogun me partinë konservative të Jaroslav Kaçinski, ishte reforma kontroverze e gjyqësisë. Sipas vlerësimit të Komisionit Evropian, pavarësia e gjykatave polake është kërcënuar, duke i sjell nën kontroll politik, ndërsa ajo paraqet edhe rrezik për gjyqësinë në të gjithë UE-në.

Zëdhënësi i qeverisë polake, Joana Kopçinjska, theksoi se "Komisioni Evropian ka të drejtë të ndërmarr hapa të tilla në përgjegjësi personale, por ato nuk janë të nevojshme".

Unioni Evropian do të mund të ngre procedurë kundër Rumanisë dhe ta dënojë nëse Bukureshti propozon me ndryshimet në gjyqësi kontestuese në sundimin e drejtësisë, paralajmëroi kryetari rumun. Ndryshimet të planifikuara në jurisprudencë janë të kritikuar edhe nga Komisioni Evropian dhe shoqatat rumune të gjykatësve.

Senati rumun në 20 dhjetor këtë vit miratoi ligj të ri në korniza të reformës më të gjerë gjyqësore në të cilën shikohet si në përpjekje politikanët të ndërmarrin kontroll në sistemin e jurisprudencës.

Liderët të Partisë socialdemokrate shpesh ftojnë në ndryshim të tre ligje për sistemin gjyqësor. Ato janë shpejtë të ndryshuara javët e fundit edhe krahas kundërshtimit të mijëra gjykatësve. Dy nga tre ligjet janë tash më në tavolinën e kryetarit rumun, ndërsa votimi përfundimtar për të tretin pritet më 21 dhjetor.

Ndryshimet të propozuara shatuan greva në gjithë Rumaninë, e cila është një nga vendet më të korruptuara në Evropë. Qytetarët në rrugë e shprehën qëndrimin se me ndryshimin e ligjeve do të kufizohet pavarësia e gjykatësve dhe prokurorëve. Partitë opozitare planifikojnë ndryshimet të atyre ligjeve t'i prononcojnë para Gjykatës Kushtetuese, por edhe kur do të merret parasysh se kryetari mund të vë veto do të kalojë shumë kohë derisa ligjet e reja fillojnë të zbatohen. Prokurorët theksojnë se ndryshimet të propozuara dukshëm do t'i zvogëlojnë hetimet, ndërsa disa të tjerë edhe plotësisht i pamundësojnë.

Debati për ndryshim dhe plotësim të Kodit penal do të vazhdojë edhe në vitin 2018.



<https://www.reuters.com>

ZGJEDHJE REGJIONALE NË KATALONI



Katalonezët e "dënuan" qeverinë qendrore spanjolle. Në zgjedhjet e mbajtura regjionale më 21 dhjetor 2017, përsëri shumicë absolute në parlamentin regjional fituan nacionalistët katalonez.

Pas zgjedhjeve parlamentare në Kataloni, nuk shihet fund i krizës e cila zgajt me muaj. Separatistët përsëri fituan shumicë absolute në parlamentin regjional. Të tria partitë të cilat angazhohen për pavarësi të Katalonisë fituan 70 nga 135 vendet në parlament. Për shumicë absolute janë të domosdoshme 68 vende të deputetëve.

Rezultati është befasues, sepse anketat e fundit tregojnë garë krah në krah të separatistëve dhe kundërshtarëve të pavarësisë së Katalonisë. Përkundër të gjitha parashikimeve, aleanca Së bashku për Kataloninë të kryetarit të mëparshëm regjional Karles Puxhdemon arriti rezultat jashtëzakonisht të mirë dhe fitoi 34 vende në parlament. Partia e majtë nacionaliste ERC kandidatit të shkëlqyeshëm i mbyllur Urioll Zhunkeras fitoi 32 vende, derisa CUP -i antikapitalist pësoi humbje të dukshme, por me katër vendet e veta të firuara mundësoi fitimin e shumicës absolute.

Fituesi i vërtet nga këto zgjedhje megjithatë është partia liberale Ciudadanos e 36-vjeçares Ines Arimadas, e cila është strikt kundër ndarjes të regjionit nga Spanja. Ciudadanos fitoi plot 36 vende në parlamentin regjional, por për shkak të rezulttit të keq të partnerëve të mundshëm të koalicionit, nuk ka shanse për formim të qeverie. Kush do të ketë kryetar regjional ende nuk është e qartë.

Kryeministri katalonez, Karlos Puxhdemon vlerësoi se rezultati nga zgjedhjet regjionale në Kataloni është "shuplakë" për qeverinë qendrore në Madrid. Kryeministri spanjoll Marijano Rahoj "humbje të plebishçit i cili vet e kërkonte", deklaroi Puxhdemon para përkrahësve të vet në Bruksel. Shumica absolute për përfaqësuesit për pavarësi është "rezultatit të cilin askush nuk mund ta mohoj", tha ai. "Kemi të drejtë të jemi të gjithë të dëgjuar", konsideron Puxhdemon. Para votimit dhe

Puxhdemon dhe Zhunkeras treguan ambicie për kryetar regjional. Nëse Puxhdemon kthehet në Kataloni i kërcënohet burgosje. Ai së bashku me anëtarët të tjerë të qeverisë së shkarkuar kataloneze është ballafaquar me akuza për shkaktim të trazira, bunt dhe keqpërdorim të mjeteve publike, për çka vijon dënim i gat me burg.

Barcelona deri para pak kohe ishte një nga metropolet më atraktive turistike në Evropë. Numri i turistëve vazhdimisht rritej. Në vitin e kaluar këtë qytet spanjoll e vizituan 7,5 milionë turist. Ndërsa ekonomia e Katalonisë, sipas të dhënave oficiale, në dy tremujorët të parë të vitit 2017 u rrit për 3,1 pikë të përqindjes në krahasim me vitin paraprak.

Megjithatë, nga fillimi i konfliktit katalonez u ndryshuan shumë punë. E gjithë ajo në ekonomi ndikon si ëndërr e keqe: 3000 ndërmarrje nga shtatori e këndej i transferuan selitë e tyre nga ky regjion. Investitorët të huaj ndër kohë e shmangin Barcelonën. Disa kruzer tash më para ndalen në Valenci. Për shkak të asaj numri i vizitorëve në Barcelonë në tremujorin e katërt për tashmë shtatë pikë të përqindjes. "Grevat, protestat, demonstratat dhe skenarët për pavarësi në kryeqytetin katalonez krijuan ambient në të cilin më shumë njerëz tashmë nuk ndjehen mirë", thuan Georg Abeg, avokat, specialist për çështje ekonomike, i cili jeton në Madrid.

Qeveria kryesore spanjolle e kontrollon Kataloninë dy muaj. Drejtorja e detyruar do të duhet të mbetet në fuqi derisa në pushtet nuk vjen qeveria e re regjionale. Në rast të bisedimeve të vështira të koalicionimit, ajo do të mund të zgjas.

<https://www.theguardian.com>

PERIUDHË E PROPOZUAR PËR ZVOGËLIM TË EMETIMEVE TË CO₂

Vendet-anëtare të Unionit Evropian më 21 dhjetor 2017 arritën marrëveshje me Parlamentin Evropian për zvogëlim të emetimeve për 30% deri në 2030 nga sektorët të transportit, hedhurina dhe bujqësi.

Marrëveshja është pjesë e përpjekjes të Komisionit Evropian për zvogëlim të emetimeve të përgjithshme të blloku për 40% deri në vitin 2030. Marrëveshjen e arritur e përcjell marrëveshja e para do kohe për arritje të zero emetimit nga pylltaria dhe ndryshimi i shfrytëzimit të tokës të kontraktuar më 14 dhjetor dhe versioni i reviduar nga skema kryesore për tregtim me emetime të UE-së (ETS), e cila i mbulon stabilimentet për prodhimtari të energjie dhe industritë të mëdha.

Biseduesit të UE-së nga vendet-anëtare dhe institucionet arritën kompromis për reformë të Sistemit për tregti me emetime (ETS) më 9 nëntor 2017. Por, grupet e gjelbra e kritikuan marrëveshjen për anulim të statusit udhëheqës të politikës klimatike për subvencionim për lëndët djegëse fosile.

"Këto marrëveshje do të thonë se korniza juridike të Politikës klimatike të UE-së 2030 është vendosur. Ajo tregon se formimi i Unionit Energjetik është në rrugën e vërtetë dhe se puna të cilën e inicion Komisioni i Junkerit dërgohet", thuhet në njoftimin e Komisionit Evropian.

Vendet-anëtare të UE-së doemos duhet t'i respektojnë qëllimet kombëtare obliguese, por mund të llogaritin në fleksibilitet, përkatësisht ato do të mund të "marrin hua" kredi për emetime nga sektorë tjerë, ato të përfshirë me ETS skenën dhe Regullativa për shfrytëzim të tokës, ndryshimi i shfrytëzimit të tokës dhe pylltari (LULUCF).

Organizatat joqeveritare për mjedis jetësor njoftuan se kjo do të mundësojë qindra milionë tonë emetime plotësuese të CO₂. "Kur bëhet fjalë për zbatimin e marrëveshjes globale për ndryshimet klimatike, përfaqësuesit kombëtar nuk mund të angazhohen për zvogëlim të emetimeve nga 30 përqind në vitin 2030, edhe kur do të jenë të nevojshme zvogëlime shumë më të forta të emetimeve që të mbetet ngrohja globale nën 2 gradë celsius sa kërkohet në Marrëveshjen e Parisit".

Sipas Shënimit për aksion klimatik, kontroll i pavarur shkencor i kontributeve kombëtare për zvogëlim të emetimeve, propozimi i UE-së për zvogëlim të emetimeve prej 40 përqind deri në vitin 2030 është e pamjaftueshme që ta përmbush premtimin për ruajtje të pragut prej 2 ° C rritje të temperaturave globale.




Vendet-anëtare, gjithashtu e ndryshuan skenarin kryesor sipas së cilës do të fillojë llogaritja e zvogëlimit të emetimeve. Parlamenti evropian kërkoi llogaritja të fillojë në vitin 2018 ndërsa Këshilli u përmbajt në bazën e mëvonshme me fillin në janar të vitit 2020. Të dyja trupat u pajtuan të fillojnë me matje të zvogëlimit të emetimeve në qershor 2019 - që është më afër te pozita e Këshillit.

Më 14 dhjetor Vendet-anëtare të UE-së arritën marrëveshje parlamentare me Parlamentin Evropian për Regullativën për shfrytëzim të tokës, ndryshimet të shfrytëzimit të tokës dhe pylltarisë (LULUCF), duke i mbyllur shkresat para votimit të sesionit plenar në janar.

Ka pak gjasa se marrëveshja e arritur nga ana e Këshillit dhe Parlamentit do të ndryshohet, por sesioni vendime të miratuara në ndryshimet disa ditë për menaxhim me hedhurina, bashkësia energjetike dhe zvogëlimi i emetimeve e sinjalizuan qëllimin e kryesimit estonez ta mbyll dosjen për mbrojtje të mjedisit jetësor.

<https://www.euractiv.com>

TAKIM I KËSHILLIT EVROPIAN



Në ditën e parë të takimit të Këshillit Evropian më 14 dhjetor 2017 liderët të UE-së miratuan konkluzione për sigurinë dhe mbrojtjen, çështjet sociale, arsimin dhe kulturën, ndryshimet klimatike dhe Jerusalemin.

Më 15 dhjetor, liderët të 27 anëtarët të UE-së e vlerësuan përparimin e bisedimeve për Bregzit dhe arritën pajtim të kalojnë në fazën e ardhshme. Ata miratuan udhëzim për fazën e dytë të bisedimeve. Gjithashtu, biseduan për ardhmërinë e unionit ekonomik dhe monetar dhe unionin bankar.

Në takimin e Këshillit Evropian e përshëndeti fillimin e bashkëpunimit të përhershëm strukturor (PESCO) në mbrojtje. Është potencuar vlera nga zbatimi i shpejtë i projekteve të para të përbashkëta.

Këshilli evropian ftoi në miratim në vitin 2018 të:

- Programit evropian për zhvillim industrial të mbrojtjes, duke pasur parasysh financimin e projekteve të para për aftësim në vitin 2019, dhe

- rekomandim të Këshillit për instrument të ri për ndërtim të kapaciteteve për përkrahje të sigurisë dhe zhvillimit pas viti 2020.

Pritet Këshilli ta përfundojë reformën të Mekanizmit athenas - instrument i cili shfrytëzohet për financim të shpenzimeve të përbashkëta për misionet ushtarake dhe operacionet të UE-së.

Këshilli evropian, gjithashtu bisedonte për bashkëpunimin ndërmjet UE-së dhe NATO-së. Liderët ftuan në implementim të plotë të aksioneve të përbashkëta, duke i përfshirë edhe ato plotësuese të cilat ishin të kontraktuara më 5 dhjetor 2017.

Liderët të UE-së këmbyen mendime për çështjet sociale, arsim dhe kulturë. Diskutimi i tyre ishte i bazuar në debatin për agjendën e liderëve për kulturë dhe arsim, si dhe të Samitit Social i cili u mbajt në Goteborg në nëntor 2017.

Ishin theksuar prioritetet për zhvillim të mëtejshëm të dimensionit social të UE-së, siç janë:

- futja e Shtyllës evropiane të drejtave sociale në nivel të UE-së dhe në nivel kombëtar,

- lehtësimi i dialogu të mirë social funksional në të gjitha nivelet,

- përparim në lidhje me dosjet sociale të cilat janë në rrjedhë në nivel të UE-së,

- Ndjekja e prioriteteve të planit aksionar të UE-së për zbatim me dallimin gjinore në rroga.

Në debatin për dimensionet të jashtme dhe të brendshme të politikës së migrimit të UE-së liderët të UE-së prononcuan pikëpamje që funksiononte, ndërsa që nuk është në dy vitet e kaluara dhe diskutonin për përforsim të politikës në atë drejtim.

Liderët të UE-së e vërtetuan angazhimin e tyre të fortë për zgjedhjen e Jerusalemi të jetë kryeqytet i të dyja shteteve.

Në bisedimet për ardhmërinë e unionit ekonomik dhe monetar (UEM) dhe unionin bankar liderët të UE-së këmbyen mendime për atë si të sigurohet se UE ka mjete adekuate për ballafaqim me shoket potenciale ekonomike. Debati ishte i ndërtuar në shënim të cilin e barti kryetari Tusk para samitit si pjesë e agjendës të liderëve. Ky shënim i theksoi idetë e shumta për të cilat ekziston konvergjençë të gjerë, siç janë:

- lëshim në përdorim të angazhimit të përbashkët - Fondi për rezolutë të vetme, më me gjasë në formë të linje të kreditimi nga Mekanizmi evropian për stabilitet (ESM),

- zhvillim i mëtejshëm i ESM, më e gjasë nga ana e të ashtuquajturat Fond evropian monetar, dhe

- Zhvillimi i mëtejshëm i Udhërrëfyesit të Këshillit të Ekofin nga qershori 2016 për kompletim plotësues të unionit bankar, duke e përfshirë edhe futjen graduale të Skenës evropiane për sigurim dhe depozita.

OPOZITA NË VENEZUELË FITUESE E SHPËRBLIMIT SAHAROV

Forca më e madhe politike në Parlamentin Evropian - Partia popullore Evropiane (EPP) - propozoi grup të opozitarëve evropian për shpërblimin e këtij viti "Saharov" për liri të mendimit: Kuvendi kombëtar, i përfaqësuar nga kryetari Hulio Borhes, dhe të gjithë të mbyllurit politik - Leopoldo Llopez, Antonio Ledesma, Daniell Sebaljos, Jon Gojkoeçea, LLoren Sallah, Allfredo Ramos dhe Andrea Gonzales.

Antonio Tajani, kryetari i Parlamentit Evropian në ceremoninë solemne më 13 dhjetor 2017 në seancën plenare të Parlamentit Evropian ia ndau shpërblimin kryetarit të Parlamentit të Venezuelës, Hulio Borhes.

Në vitet e fundit Venezuela është në krizë politike. Partia qeveritare në mënyrë sistemore e kufizon sundimin e drejtësisë dhe rendit kushtetues, ndërsa në mars 2017 Gjykata Supreme i zgjedhur në mënyrë demokratike në kuvendin kombëtar e ndërmoi pushtetin ligjvënës. Kryetari i kuvendit kombëtar, Xhulio Borges e përshkruaj situatën në Venezuelë me këto terme: "Në Venezuelë, ky nuk është vetëm konflikt politik. Ky është konflikt shumë i rëndësishëm ekzistencial i bazuar në vlera".

Organizata bamirëse „Foro Penal Venezolano“, e cila kujdesej për të

burgosurit politik në Venezuelë, gjithashtu ishte shpërblyer me shpërblimin Saharov. Pas raportit të fundit të grupit, rreth 600 persona gjenden në burg për shkak të bindjeve të tyre politike, ndër të cilat edhe lideri i opozitës Leopoldo Llopez. Ai është në burg më gjatë se tre vjet pa ndërprerje. Ndër të burgosurit politik janë Jon Gojoçe dhe Andrea Gonzales, me më së paku dy qytetarë spanjoll, thuhet në njoftimin e Parlamentit Evropian. Nga fillimi i vitit më shumë se 120 përfaqësues të opozitës ishin të varurë.

Shpërblimi "Për liri të mendimit", i cili e mban emrin Andrej Saharov, është themeluar nga PE në vitin 1988 në nder të fizikantit sovjetik dhe fitues i Shpërblimit Nobel për paqe për vitin 1975, i cili ishte një nga liderët të lëvizjes për mbrojtje të të drejtave të njeriut në Bashkimin Sovjetik. Shpërblimi ndahet për njerëz dhe organizata për merita në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

<http://www.dw.com/>



UE KALENDAR / janar 2018

1. Onlajn kurs (MOOS) i Komitetit Evropian i regjioneve, 15/01/2018, onlajn platformë për mësim;
2. Ditë Evropiane e Energjisë, 16/01/2018, Abu Dabi, EBA;
3. Sesion plenar i Parlamentit Evropian, 15-18/01/2018, Strasburg.
4. Takim i Këshillit Evropian, 22/01/2018, Bruksel.

European Union
Newsroom

EUROPA > Newsroom > Calendar

Home
Highlights
Press releases
Calendar
Audiovisual
Press contacts
Press facilities
About the EU

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic

By organiser

By type

BY MONTH

January

Sun	Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			



KUVENDIN I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

UE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Tetori nr. 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 33 lokal 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ishte i zbatuar IPA Projekti për "Ndhimë teknike për Parlamentin", në periudhën janar 2011 - qershor 2012, qëllimi i përgjithshëm ishte përforcimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit dhe me të përmirësim të transparencës së tij dhe përgjegjësi para qytetarëve.

Në korniza të IPA projektit, ishte siguruar ndihmë financiare dhe profesionale për vendosje të UE qendrës në Kuvend.

Qëllimi i formimit të ZE qendrës është deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe të Shërbimit të Kuvendit t'u sigurohet qasje më e mirë te informata të lidhura me UE pyetje.

UE qendra është organizuar në korniza të Sektorit për përkrahje të Këshillit kombëtar për eurointegrimi.

UE qendra disponon me bibliotekë me libra dhe publikime nga sfera të ndryshme të politikave evropiane.

